

## RELACION

### PËR

### PËR PROJEKTLIGJIN “PËR SISTEMIN E PAGESAVE DHE KOLATERALIN FINANCIAR ”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj hartohet në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Europian në fushën e sistemeve të pagesave, tregjeve financiare dhe stabilitetit financiar. Më konkretisht, transpozimi i plotë i Direktivës 98/26/KE të ndryshuar dhe Direktivës 2002/47/KE janë pjesë e *Benchmark* të Kapitullit 9.

Ai synon gjithashtu forcimin e sigurisë juridike në transaksionet financiare dhe integrimin progresiv të tregut financiar shqiptar me tregjet europiane.

Projektligji parashikon krijimin e një kuadri të ri, të plotë dhe të konsoliduar ligjor për funksionimin, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen juridike të sistemeve të pagesave dhe të sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë. Në të njëjtën kohë, projektligji garanton sigurinë dhe efikasitetin e ofrimit dhe përdorimit të kolateralit financiar, si dhe siguron mbrojtjen e të drejtave të palëve në marrëveshjen e kolateralit financiar nëse njëra prej palëve i nënshtrohet procedurave të likuidimit. Në këtë kuadër, ai shfuqizon dispozitat ekzistuese që rregullojnë finalitetin e shlyerjes dhe kolateralin financiar, duke synuar një rregullim më të qartë, më të unifikuar dhe më efikas.

Projektligji siguron përafrim të mëtejshëm me legjislacionin e Bashkimit Europian, në veçanti me:

- Direktivën 98/26/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998, “Për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë”, e ndryshuar me:
  - a. Direktivën 2009/44/KE, datë 6 maj 2009;
  - b. Direktivë (BE) 2010/78, datë 24 nëntor 2010
  - c. Direktivën (BE) 2019/879, datë 20 maj 2019;
- Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 qershor 2002, “Për marrëveshjet e kolateralit financiar”, e ndryshuar me:
  - a. Direktivën 2009/44/KE, datë 6 maj 2009;
  - b. Direktivën 2014/59/BE, datë 15 maj 2014;

Gjithashtu, projektligji merr në konsideratë dhe reflekton zhvillimet më të fundit të *acquis* të Bashkimit Europian, duke përfshirë ndërveprimin me rregullore të rëndësishme në fushën e infrastrukturave financiare dhe sistemeve të pagesave, në veçanti:

1. Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 4 korrik

- 2012, “Për derivatet OTC, kundërpative qendrore dhe regjistrat e tregtimit” (EMIR);
2. Rregulloren (BE) nr. 909/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014, “Për përmirësimin e shlyerjes së letrave me vlerë në Bashkimin Europian dhe për depozitarët qendrorë të letrave me vlerë” (CSDR);
  3. Rregulloren (BE) 2021/23 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2020, “Për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e kundërpative qendrore;
  4. Rregulloren (BE) 2024/886 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 mars 2024, “Për pagesat e menjëhershme në euro” (Instant Payments Regulation), e cila ndryshon Rregulloren (BE) nr. 260/2012 (SEPA Regulation);

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji është në përputhje me prioritetet e Programit Politik të Këshillit të Ministrave dhe me Programin Analitik të Akteve, duke adresuar nevojën për forcimin e stabilitetit financiar dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare në vend.

Në mënyrë të veçantë, ai kontribuon në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të sektorit, rritjen e sigurisë juridike në transaksionet financiare dhe modernizimin e infrastrukturave të pagesave, në linjë me zhvillimet më të fundit europiane. Projektligji përbën gjithashtu një masë (*benchmark*) të përcaktuar në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian, në veçanti në Kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, duke mbështetur drejtpërdrejt përmbushjen e detyrimeve të përafrimit me *acquis*.

Njëkohësisht, ai është në përputhje me objektivat e dokumenteve strategjike sektoriale për rritjen e konkurrueshmërisë, integrimin e tregut financiar shqiptar dhe nxitjen e inovacionit në shërbimet financiare.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Kuadri aktual ligjor, ndonëse ka shërbyer si bazë për funksionimin e sistemeve të pagesave dhe për mbrojtjen e parimit të finalitetit të shlyerjes, paraqet mangësi strukturore dhe substanciale, të cilat pengojnë harmonizimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Europian dhe cenojnë zhvillimin e sigurt dhe efikas të tregut financiar shqiptar.

Legjislacioni ekzistues nuk reflekton plotësisht evolucionin e kuadrit rregullator europian në fushën e infrastrukturave financiare dhe nuk garanton nivelin e kërkuar të sigurisë juridike për pjesëmarrësit në treg. Mungesa e instrumenteve të caktuara juridike krijon paqartësi në zbatim, rrit ekspozimin ndaj rreziqeve sistemike dhe kufizon aftësinë e autoriteteve për të ushtruar mbikëqyrje efektive.

Në mënyrë të veçantë, mosparashikimi i mekanizmit të njohjes (“*designation*”) të sistemeve që përfitojnë mbrojtje nga finaliteti i shlyerjes përbën një boshllëk të rëndësishëm ligjor. Ky mekanizëm është thelbësor në kuadër të legjislacionit të Bashkimit Europian dhe përbën një standard bazë për garantimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes. Mosadresimi i tij deri më sot,

pavarësisht vështirësive praktike të hasura në të kaluarën, nuk është më i justifikueshëm në kushtet e angazhimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Po ashtu, legjislacioni aktual nuk rregullon në mënyrë të plotë dhe të qartë një sërë elementesh thelbësore, të cilat konsiderohen të domosdoshme për funksionimin e një infrastrukture moderne financiare, konkretisht:

1. mungojnë procedura të qarta dhe të standardizuara për njohjen (“*designation*”) e sistemeve që përfitojnë mbrojtje nga finaliteti i shlyerjes;
2. nuk parashikohen mekanizma të qartë për komunikimin dhe njoftimin me autoritetet kompetente të Bashkimit Evropian, në kundërshtim me kërkesat e bashkëpunimit ndërinstitucional;
3. nuk ekziston një kuadër i plotë juridik për trajtimin e sistemeve ndërlidhura (intreporable), çka kufizon zhvillimin dhe integrimin e infrastrukturave të tregut;
4. trajtimi i “*credit claims*” si formë e kolateralit financiar mbetet i papërcaktuar, duke kufizuar përdorimin e instrumenteve bashkëkohore të menaxhimit të rrezikut;
5. mungon një rregullim i qartë për koordinimin dhe trajtimin juridik në rastet e procedurave ndërkufitare të paafëtisë pague, duke krijuar pasiguri në zbatim dhe rrezik për konflikt normash.

Në këtë situatë, vijimi me kuadrin aktual ligjor do të nënkuptonte ruajtjen e boshllëqeve rregullatore, rritjen e pasigurive juridike dhe mosrespektimin e standardeve të kërkuara nga *acquis* i Bashkimit Evropian.

Për rrjedhojë, miratimi i këtij projektligji paraqitet jo vetëm si një nevojë teknike për përmirësimin e kuadrit ligjor, por si një domosdoshmëri thelbësore për garantimin e stabilitetit financiar, forcimin e besimit në tregjet financiare dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

#### **Përparësitë e projektligjit:**

- Përmbush një nga *benchmark* të kapitullit 9” Shërbimet Financiare” duke mundësuar kështu arritjen e të gjitha nevojave të parashikuara për mbylljen e këtij kapitulli përse i përket nënkaptullit “Tregjet Financiare”.
- Plotësimi i mangësive ligjore të cilat qartësojnë statusin juridik dhe mbrojtjen e sistemeve me finalitet shlyerjeje në vend.
- Zgjerimi i përdorimit të instrumenteve financiare, përmes njohjes ligjore të pretendimeve kreditore (*credit claims*) si formë e re dhe e pranuar e kolateralit financiar dhe përmirësimi i kuadrit të përgjithshëm për marrëveshjet e kolateralit financiar. Krijon bazën ligjore për marrjen e opinionit të ISDA-së për Shqipërinë, si një element kyç për zhvillimin e tregjeve financiare, rritjen e besueshmërisë së juridiksionit dhe zgjerimin e përdorimit të instrumenteve financiare.

#### **Efektet e pritshme:**

Miratimi i këtij projektligji pritet të sjellë një sërë efektesh pozitive në funksionimin dhe zhvillimin e tregut financiar në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- a. Forcimin e stabilitetit financiar, përmes rritjes së sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë;
- b. Rritjen e sigurisë juridike në transaksionet financiare, duke garantuar qartësi dhe

- mbrojtje më të madhe për pjesëmarrësit në sisteme;
- c. Përafrimin e plotë me *acquis* të Bashkimit Europian, në fushën e sistemeve të pagesave, kolateralit financiar dhe infrastrukturave të tregjeve financiare;
  - d. Lehtësimin e integritetit të tregut financiar shqiptar me tregjet europiane, duke krijuar kushtet për ndërveprim më të sigurt dhe efikas me sistemet ndërkombëtare;
  - e. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturave financiare, veçanërisht në drejtim të sistemeve ndërvepruese dhe inovacionit në pagesa;
  - f. Përfshirja e pretendimeve kreditore (*credit claims*) si kolateral financiar krijon mundësinë që bankat/institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare të zgjerojnë gamën e aktiveve duke rritur likuiditetin, efikasitetin e administrimit të rrezikut dhe aksesin në financim;
  - g. Rritjen e besueshmërisë së juridiksionit shqiptar për investitorët vendas dhe të huaj, duke përmirësuar klimën e biznesit dhe duke ulur rreziqet ligjore;
  - h. Mundësimin e marrjes së opinionit të ISDA-së për Shqipërinë, duke kontribuar në zhvillimin e tregjeve dhe instrumenteve financiare dhe në integrimin me tregjet ndërkombëtare;
  - i. Përmirësimi i menaxhimit të rreziqeve sistemike, përmes rregullimit më të plotë të finalitetit të shlyerjes dhe trajtimit të situatave të paaftësisë paguese, përfshirë ato ndërkufitare;
  - j. Rritja e efikasitetit dhe shpejtësisë së shlyerjes së pagesave, në përputhje me zhvillimet më të fundit europiane, përfshirë pagesat e menjëhershme (instant payments).

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji është hartuar në përputhje me *acquis* të Bashkimit Europian në fushën e sistemeve të pagesave, infrastrukturave të tregjeve financiare dhe stabilitetit financiar, pjesë e Kapitullit 9 –“Shërbimet financiare” në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim.

Në mënyrë të veçantë, projektligji synon përafrimin me:

- Direktivën 98/26/KE “Për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, të ndryshuar;
- Direktivën 2002/47/KE “Për marrëveshjet e kolateralit financiar”, të ndryshuar;

si dhe reflekton zhvillimet e *acquis* përmes rregulloreve përkatëse (EMIR, CSDR, Rregullorja 2021/23 dhe Rregullorja 2024/886 për pagesat e menjëhershme).

#### **Vlerësimi i shkallës së përafrimit:**

**Direktiva 98/26/KE (Settlement Finality Directive):**  
**Shkalla e përafrimit: Përafrim i plotë**

Projektligji transponon elementet thelbësore të direktivës, përfshirë:

- a. konceptin e njohjes së sistemeve të pagesave dhe klerime dhe shlyerjes së titujve;
- b. mbrojtjen e finalitetit të shlyerjes;
- c. trajtimin e urdhrave të transfertave dhe momenteve të hyrjes në sistem;
- d. njohjen e efekteve juridike në rastet e procedurave të paftësisë paguese;
- e. krijimi e konceptit të sistemeve të ndëvepruehme dhe trajtimin e rasteve të shfaqes së paftësisë paguese në të tilla raste.

**Direktiva 2002/47/KE (Financial Collateral Directive):**  
**Shkalla e përafrimit: Përafrim i plotë**

Projektligji përfshin kërkesat kryesore të direktivës, si:

- a. njohjen dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit financiar;
- b. eliminimin e formaliteteve të panevojshme për krijimin e kolateralit;
- c. përfshirjen e “credit claims” si formë kolateralit;
- d. njohjen dhe zbatueshmërinë e netimit përfundimtar (*close-out netting*) pavarësisht procedurave të paftësisë paguese;
- e. rregullimin e të drejtës së përdorimit (*right of use*) të kolateralit në marrëveshjet kolateralit financiar me vendosje pengu;
- f. kufizimin e zbatimit të disa dispozitave të falimentimit ndaj marrëveshjeve të kolateralit financiar.

**Vlerësim i përgjithshëm**

Në tërësi, projektligji vlerësohet të ketë arritur një nivel të plotë të përafrimi me *acquis* të Bashkimit Europian.

Projektligji kontribuon drejtpërdrejt në avancimin e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 9” Shërbimet financiare”, duke adresuar boshllëqet kryesore të identifikuar në përputhshmërinë me dy direktiva, si dhe duke ndihmuar fazat e mëtejshme të negociatave.

**VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji “Për sistemet e pagesave” synon krijimin e një kuadri të ri, të plotë dhe të konsoliduar ligjor për rregullimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me standardet dhe kërkesat e *acquis* të Bashkimit Europian. Ai adreson nevojën për modernizimin e kuadrit ekzistues ligjor, forcimin e sigurisë juridike dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturave financiare, si elemente thelbësore për stabilitetin financiar dhe integrimin europian.

Projektligji është i organizuar në kapituj tematikë, të cilët trajtojnë në mënyrë të strukturuar dhe të detajuar çështjet kryesore të këtij sektori:

**Kreu I – Dispozita të përgjithshme** -përcakton objektin, qëllimin dhe fushën e zbatimit të ligjit, si dhe jep përkufizimet e termave kyç të përdorur në të. Në këtë kapitull theksohet roli i Bankës së Shqipërisë si autoriteti kryesor përgjegjës për rregullimin, mbikëqyrjen dhe operimin e sistemeve të pagesave. Gjithashtu, parashikohet bashkëpunimi ndërinstytucional me autoritete të tjera vendase dhe të huaja, si dhe krijimi i strukturave këshilluese, në funksion të zhvillimit të politikave në fushën e sistemeve të pagesave.

Në vijim evidentojmë risitë kryesore të sjella nga projektligji krahasuar me ligjin ekzistues. Në ligjin ekzistues nr. 133/2013, neni 1 (Qëllimi) dhe neni 2 (Objekti) fokusohen kryesisht në funksionimin e sistemit kombëtar të pagesave dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në sigurimin e stabilitetit dhe efikasitetit të tij. Përkufizimet në nenin 4 janë relativisht të kufizuara dhe të orientuara drejt sistemeve tradicionale të pagesave dhe shlyerjes.

Projektligji i ri, në nenet 1 dhe 2, ruan qëllimin bazë të ligjit ekzistues, por e zgjeron ndjeshëm objektin e tij, duke përfshirë jo vetëm sistemet e pagesave, sistemet e shlyerjes së titujve dhe shtëpive të klerimit të titujve por dhe depozitarët qendrorë dhe Kundërpartitë Qendrore (CCP). Ky zgjerim nuk ekziston në ligjin aktual.

Ndryshimi më i rëndësishëm në këtë kapitull qëndron në nenin 5 (Përkufizime) të projektligjit, i cili zgjeron ndjeshëm terminologjinë, harmonizon përkufizimet me direktivat dhe rregulloret e BE-së, dhe për herë të parë përfshin shprehimisht termat: “sistemeve të ndëveprueshme” , “pretendimet kreditore” (“*credit claims*”) si formë kolaterali, njohjen (“*disigantion*”) e sistemeve etj.

Këto elemente nuk janë të pranishme në ligjin nr. 133/2013 dhe përfaqësojnë një kalim nga një ligj me fokus kombëtar në një ligj të ndërtuar për integrim europian.

**Kreu II – Rregullimi dhe mbikëqyrja e sistemeve**- rregullon në mënyrë të detajuar procedurat për licencimin dhe miratimin e sistemeve të pagesave dhe sistemeve të tjera të lidhura me infrastrukturën financiare. Ky kapitull përcakton qartë kompetencat e Bankës së Shqipërisë në drejtim të mbikëqyrjes, duke përfshirë të drejtën për të vendosur kërkesa rregullatore shtesë, për të kryer inspektime dhe për të ndërmarrë masa administrative dhe sanksionuese në rast të shkeljeve. Gjithashtu, parashikohet bashkëpunimi institucional me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për sistemet e lidhura me tregjet e kapitaleve.

Ligji nr. 133/2013, në nenet 6–12, i jep Bankës së Shqipërisë kompetenca të gjera për licencimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e sistemeve të pagesave. Megjithatë, ndarja e roleve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbetet relativisht e përgjithshme. Projektligji i ri, në nenet 6–8, e detajon qartë:

- i. dallimin midis licencimit dhe miratimit të sistemeve nga entitetet të ndryshme.
- ii. rastet kur përfshihet AMF-ja,
- iii. dhe procedurat për sistemet e shlyerjes së titujve, Depozitarët Qendror dhe Kundërpartitë Qendrore (CCP-të).

Në nenin 1 të projektligjit forcohen ndjeshëm kompetencat mbikëqyrëse të Bankës së

Shqipërisë, duke i dhënë asaj mundësi më të gjera për inspektim dhe ndërhyrje parandaluese, krahasuar me nenin përkatës të ligjit ekzistues në të gjitha infrastrukturën e tregjeve financiare të cilat në vitin 2013 kur u miratua ligji ekzistues parë nuk ishin definuar dhe rregulluar nga legjislacioni shqiptar

Një risi që mungon në ligjin nr. 133/2013 është neni 10 i projektligjit, i cili parashikon shprehimisht kompetenca vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë për të adresuar rreziqe sistematike, duke reflektuar standardet e BE-së mbi mbikëqyrjen (oversight) në tërësinë e infrastrukturave financiare.

**Kreu III – Mbrojtja e sistemeve** - përbën një komponent thelbësor të projektligjit, pasi trajton mekanizmat për mbrojtjen e stabilitetit dhe funksionimit të sistemeve në situata krize, në veçanti në rastet e procedurave të shfaqes së paaftësisë paguese. Ky kapitull sanksionon parimin e finalitetit të shlyerjes, sipas të cilit urdhër -transferta dhe proceset e netimit janë të përvokueshme dhe juridikisht të detyrueshme për palët dhe për palët e treta. Po ashtu, përcaktohen efektet juridike të procedurave të shfaqes së paaftësie paguese mbi pjesëmarrësit dhe sistemet, si dhe garantohen të drejtat mbi kolateralin financiar. Në këtë kuadër, projektligji përfshin për herë të parë mekanizmin e njohjes “*designation*” të sistemeve, si dhe rregulla për sistemet ndërvepruese dhe për komunikimin me autoritetet e Bashkimit Europian.

Më në detaje, ligji ekzistues parashikon në nenet 13–18 parimin e finalitetit të pagesës, përvokueshmërinë e urdhrave të transfertës dhe mbrojtjen nga efektet prapavepruese të falimentimit. Ky regjim është i fokusuar kryesisht në pagesat dhe shlyerjen tradicionale. Projektligji, në nenet 15–26, jo vetëm që i ruan këto parime, por i zgjeron ato për sistemet ndërvepruese, Kundërpartitë Qendrore dhe Depozitarët Qendrore si dhe përcakton që këto dispozita zbatohen dhe për rastet e ndërhyrjes jashtëzakonshme, jo vetëm për shfaqen e paaftësisë paguese.

Një ndryshim thelbësor krahasuar me ligjin nr. 133/2013 është neni 22 i projektligjit, i cili parashikon se masat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk cenojnë finalitetin e pagesave dhe kompensimit, në përputhje me *Bank Recovery and Resolution Directive* (BRRD). Ky koncept mungon plotësisht në ligjin aktual.

Gjithashtu, nenet 23 dhe 24 të projektligjit forcojnë ndjeshëm mbrojtjen e kolateralit në rast paaftësie paguese, duke e lidhur drejtpërdrejt me Kapitullin V, gjë që nuk bëhet në mënyrë të strukturuar në ligjin ekzistues.

**Kreu IV – Sistemet e Bankës së Shqipërisë**- përmban dispozita të posaçme për sistemet që administrohen dhe operohen nga Banka e Shqipërisë. Në këtë kapitull përcaktohen rregullat e funksionimit të këtyre sistemeve, përfshirë momentin e hyrjes së urdhrave në sistem, përvokueshmërinë e tyre, procedurat e shlyerjes dhe menaxhimin e rreziqeve. Gjithashtu, parashikohen masa administrative dhe sanksione ndaj pjesëmarrësve në rast të mosrespektimit të rregullave të sistemit.

Më në detaje në kuadër të përmbajtjes, të dy ligjet përjashtojnë sistemet e operuara nga Banka e Shqipërisë nga licencimi. Megjithatë, projektligji në nenin 28 detajon shumë më qartë rregullat operative, rrezikut e riskut dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve.

Një risi krahasuar me ligjin nr. 133/2013 është neni 29, i cili parashikon masa administrative dhe gjoba edhe për pjesëmarrësit në sistemet e Bankës së Shqipërisë, duke rritur disiplinën dhe përputhshmërinë me standardet CPMI-IOSCO.

**Kreu V – Marrëveshja e kolateralit financiar** - krijon një kuadër të plotë dhe të harmonizuar me Direktivën 2002/47/EC për marrëveshjet e kolateralit financiar, me synimin për të rritur sigurinë juridike, efikasitetin e tregjeve financiare dhe përdorimin e kolateralit financiar në transaksionet ndërmjet institucioneve financiare dhe subjekteve të tjera të kualifikuara. Dispozitat e tij përcaktojnë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit financiar, kufizojnë formalitetet për krijimin dhe ekzekutimin e tyre, si dhe rregullojnë mekanizmat e ekzekutimit të kolateralit dhe netimit përfundimtar (close-out netting), duke reduktuar rrezikun juridik dhe operacional në tregjet financiare. Një nga risitë kryesore të këtij kapitulli është përfshirja e pretendimeve kreditore (credit claims) si një kategori e re kolaterali financiar, krahas parave *cash* dhe instrumenteve financiare. Për këtë kategori janë parashikuar rregulla të posaçme që lidhen me identifikimin e pretendimeve kreditore, provën e dhënies së tyre si kolateral, njoftimin e debitorit, regjistrimin, prioritetin ndërmjet kreditorëve konkurrues dhe efektet ndaj palëve të treta. Këto dispozita parashikohen në nenin 32 të projektligjit. Ky nen përcakton vlefshmërinë dhe njohjen e marrëveshjes së kolateralit financiar. Parimi themelor është se marrëveshja është e vlefshme nëse mund të provohet me shkrim ose në formë elektronike, pa kërkuar regjistrim, publikim, noterizim apo formalitete të tjera burokratike. Ky parimi është sidomos i rëndësishëm në rastin e pretendimeve kreditore (credit claims). Këto dispozita krijojnë bazën ligjore për përdorimin e portofoleve të kredive të institucioneve të kreditit si kolateral financiar, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Një risi tjetër e rëndësishme është zgjerimi dhe sqarimi i kategorive të subjekteve që mund të jenë palë në një marrëveshje kolaterali financiar. Neni 30 i projektligjit përcakton kategoritë e subjekteve që mund të jenë palë në këto marrëveshje. Krahas institucioneve tradicionale financiare, dispozitat përfshijnë një gamë më të gjerë subjektësh publike dhe private, duke harmonizuar kategoritë e palëve të kualifikuara me ato të parashikuara në direktivë dhe duke krijuar siguri më të madhe juridike për pjesëmarrësit në treg.

Neni 31 i projektligjit sqaron më tej kategoritë e aktiveve dhe marrëdhënieve juridike që nuk përfshihen nga regjimi i posaçëm i kolateralit financiar, veçanërisht në lidhje me disa lloje aksionesh dhe pretendimesh kreditore ndaj konsumatorëve dhe ndërmarrjeve mikro ose të vogla. Këto kufizime synojnë të ruajnë ekuilibrin ndërmjet lehtësisë të përdorimit të kolateralit financiar dhe mbrojtjes së kategorive që konsiderohen më të ekspozuara ndaj rrezikut.

Neni 33 i projektligjit rregullon ekzekutimin e kolateralit financiar me ndodhjen e një ngjarjeje mospërmbushjeje. Ai parashikon tri mënyra ekzekutimi për instrumentet financiare (shitje, përvetësim/appropriation, kompensim), dy mënyra për para cash (kompensim, përdorim drejtpërdrejtë) dhe tri mënyra për pretendimet kreditore (shitje, përvetësim, kompensim vlere). Në të gjitha rastet, ekzekutimi kryhet pa kërkuar shpallje publike, miratim nga gjykata ose procedura të veçanta. Vlerësimi i kolateralit bazohet në vlerën e tregut ose, në mungesë të kësaj, në modele financiare të pranura gjerësisht, duke garantuar arsyeshmëri tregtare dhe shmangur veprimet arbitrare.

Neni 34 dhe Neni 35 rregullojnë respektivisht të drejtën e përdorimit (*right of use*) në marrëveshjet e kolateralit financiar me vendosje pengu dhe efektet në marrëveshjet e kolateralit financiar me transferim pronësie. E drejta e përdorimit lejon marrësin e kolateralit të shesë, transferojë ose ri-investojë kolateralin, me detyrimin që të kthejë kolateral ekuivalent jo më vonë se data e përmbushjes së detyrimeve financiare përkatëse.

Këto dispozita rregullojnë qëllimisht situatat kur ndodh një ngjarje mospërmbushjeje ndërkohë që detyrimi për kthimin e kolateralit ekuivalent mbetet i papërmbushur, rast në të cilin detyrimi mund t'i nënshtrohet netimit përfundimtar (*close-out netting*), duke shmangur rreziqet e dyfishëzimit ose moskoordinimit të pretendimeve.

Neni 36 rregullon dy mekanizma praktikë që mund të parashikohen në marrëveshjen e kolateralit financiar: detyrimin për të dhënë kolateral shtesë kur vlera e kolateralit ose shuma e detyrimeve ndryshon, dhe të drejtën për të zëvendësuar kolateralin ekzistues me kolateral tjetër me vlerë të njëjtë. Parimi themelor i nenit është se asnjë nga këto veprime — dhënia e kolateralit shtesë, zëvendësimi apo tërheqja e kolateralit të tepërt — nuk konsiderohet lidhje e një marrëveshjeje të re, duke shmangur kështu rrezikun e pavlefshmërisë retroaktive në rast falimentimi. Po ashtu, ushtrimi i të drejtave të dhënësit të kolateralit (zëvendësim, tërheqje teprice, mbledhje pagesash nga pretendimet kreditore) nuk cenon vlefshmërinë apo efektivitetin e marrëveshjes origjinale.

Neni 37 rregullon njohjen dhe zbatueshmërinë e netimit përfundimtar (*close-out netting*). Ky mekanizëm përcakton që në rast mospërmbushjeje, të gjitha detyrimet ndërmjet palëve bëhen menjëherë të kërkueshme, llogariten neto dhe përcaktohet një shumë e vetme përfundimtare që paguhet nga njëra palë. Ky mekanizëm zbatohet pavarësisht fillimit të procedurave të falimentimit, likuidimit apo çdo kufizimi tjetër të ushtrimit të të drejtave duke garantuar sigurinë juridike maksimale në transaksionet financiare.

Neni 38 kufizon zbatimin e disa dispozitave të paaftësisë paguese ndaj marrëveshjeve të kolateralit financiar. Konkretisht, një marrëveshje kolaterali financiar nuk mund të shpallet e pavlefshme ose të revokohet vetëm për shkak se është lidhur në ditën e fillimit të procedurës së paaftësisë paguese ose përpara fillimit të këtyre procedurave. Ky kufizim ka si qëllim të shmangë pasiguritë për palët e treta që kanë hyrë në marrëdhënie kolaterali financiar në mirëbesim. Kur pala mund të provojë se nuk ishte në dijeni për fillimin e procedurave, marrëveshja e kolateralit financiar prodhon efekte të plota ndaj palëve të treta, përfshirë likuidatorin. Neni 39 përcakton se marrësi i kolateralit gëzon përparësi ndaj kreditorëve të tjerë mbi kolateralin financiar, ndërsa për pretendimet kreditore kjo përparësi kushtëzohet nga regjistrimi sipas rregullave të këtij ligji. Neni 40 rregullon ndërveprimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Neni parashikon që kufizimet ose pezullimet e përkohshme të parashikuara nga atë legjislacion nuk cenojnë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit financiar, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ai legjislacion. Neni 41 plotëson këtë trajtim me rregullat e ligjit të zbatueshëm për titujt e dematerializuar, duke sanksionuar parimin që zbatohet ekskluzivisht ligji i shtetit ku mbahet llogaria ose regjistri përkatës, duke garantuar një rregull të qartë ndërkombëtar konflikti të ligjeve.

Në tërësi, Kreu V përafron legjislacionin shqiptar me standardet evropiane në fushën e kolateralit financiar dhe krijon kushtet për një përdorim më efikas të kolateralit, një menaxhim më të mirë të rrezikut financiar dhe një funksionim më të sigurt të tregjeve financiare.

Harmonizimi i këtij kuadri me Direktivën 2002/47/EC përbën gjithashtu një hap të rëndësishëm drejt krijimit të kushteve ligjore të nevojshme për përfshirjen e Shqipërisë në juridiksionet për të cilat mund të lëshohen opinione ligjore të netimit (ISDA Netting Opinions). Njohja dhe mbrojtja ligjore e netimit përfundimtar, e marrëveshjeve të kolateralit financiar dhe e efekteve të tyre në rast falimentimi janë elemente themelore që vlerësohen në procesin e përgatitjes së këtyre opinioneve dhe kontribuojnë në zhvillimin e tregjeve financiare dhe transaksioneve ndërkombëtare me instrumente derivative dhe repo.

**Kreu VI – Dispozita mbi provat**-rregullon çështjet që lidhen me provueshmërinë e transaksioneve në sistemet e pagesave, duke njohur vlefshmërinë e provave elektronike dhe optike. Ky kapitull përfshin gjithashtu dispozita për procedura teknologjike si “*truncation*”, në përputhje me zhvillimet moderne në përpunimin e instrumenteve të pagesave. Këto dispozita kanë qenë edhe në ligjin ekzistues “Për sistemin e Pagesave”

Në pjesën përfundimtare, projektligji parashikon shfuqizimin e ligjit nr. 133/2013 “Për sistemin e pagesave”, duke e zëvendësuar atë me një kuadër më të avancuar dhe të harmonizuar me *acquis* të Bashkimit Europian. Gjithashtu, përcaktohen dispozita kalimtare për hyrjen në fuqi të disa neneve specifike, të cilat lidhen me momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëri e plotë me detyrimet që rrjedhin nga ky proces.

Në tërësi, projektligji përfaqëson një reformë të rëndësishme në fushën e sistemeve të pagesave dhe infrastrukturave financiare, duke krijuar kushte për rritjen e sigurisë, efikasitetit dhe besueshmërisë së tregut financiar shqiptar, si dhe për integrimin e tij të mëtejshëm në tregjet financiare europiane dhe ndërkombëtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTLIGJIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Banka e Shqipërisë dhe Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare për kreun II dhe III në cilësinë e autoriteteve rregullator dhe mbikëqyrës të tregut të sistemeve të pagesave dhe tregjeve financiare.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT.**

Projektligji është hartuar nga Banka e Shqipërisë dhe është konsultuar me aktorët e tregut si dhe Ministrinë përkatëse.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk vlerësohet të ketë efekte të posaçme të paparashikuara në buxhetin e shtetit.